

20100751369

L I G J
PËR MENAXHIM ME TRASHËGIMINË BOTËRORE NATYRORE DHE
KULTURORE NË RAJONIN E OHRIT

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Lënda e rregullimit

(1) Me këtë ligj rregullohet menaxhimi me trashëgiminë natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit, e regjistruar në listën e trashëgimisë botërore natyrore dhe kulturore të Konventës për mbrojtje të trashëgimisë botërore kulturore dhe natyrore të Kombeve të Bashkuara në kuadër të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (në tekstin e mëtejshëm: Konventa e UNESCO-s).

(2) Me këtë ligj rregullohen të drejtat dhe obligimet e Republikës së Maqedonisë, të komunave Ohër, Strugë dhe Debërcë, si dhe të drejtat dhe detyrat e personave juridikë dhe fizikë lidhur me menaxhimin me trashëgiminë botërore natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit, e regjistruar në listën e trashëgimisë botërore natyrore dhe kulturore të Konventës së UNESCO-s (në tekstin e mëtejshëm: trashëgimia botërore natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit).

Neni 2

Zbatimi i Ligjit

(1) Dispozitat e këtij ligji zbatohen në rajonin e Ohrit në të cilin ekziston trashëgimi natyrore dhe kulturore që është e përcaktuar si trashëgimi botërore natyrore dhe kulturore.

(2) Menaxhimi me trashëgiminë botërore natyrore dhe kulturore është me interes publik, që kryhet në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji.

(3) Zbatimi i masave për menaxhim me trashëgiminë botërore natyrore dhe kulturore të parashikuara me këtë ligj, nuk guxon që drejtpërdrejtë apo tërthorazi, të sjellë në përkeqësim të gjendjes me trashëgiminë botërore natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit.

(4) Të gjitha masat, standardet dhe qëllimet e mjedisit jetësor, të mbrojtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore, zbatohen si kërkesa minimale të cilat duhet të përmbushen gjatë menaxhimit me trashëgiminë botërore natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit.

(5) Nëse me këtë apo me ligj tjetër janë të përcaktuara masat, standardet dhe qëllimet e mjedisit jetësor, të mbrojtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore, gjatë menaxhimit me trashëgiminë botërore natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit, do të zbatohen masat më të rrepta dhe standardet me qëllim të mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe mbrojtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

Neni 3

Qëllimi i Ligjit

Qëllimet e këtij ligji janë:

- krijimi i kushteve për zbulim, mbrojtje, popullarizim dhe përparim të gjendjes me trashëgiminë botërore natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit,

- bartja e vlerave të jashtëzakonshme të trashëgimisë botërore natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit gjeneratave të ardhshme, si pjesë e trashëgimisë së përgjithshme të tërë njerëzimit,

- realizimi i hulumtimeve shkencore dhe aktiviteteve edukativo-arsimore,

- krijimi i kushteve për zhvillim të qëndrueshëm të Republikës së Maqedonisë dhe komunave të Ohrit, Strugës dhe Debërcës, nëpërmjet shfrytëzimit përkatës të trashëgimisë botërore natyrore dhe kulturore të rajonit të Ohrit,

- parandalimi i aktiviteteve të cilat negativisht ndikojnë ndaj vlerave të jashtëzakonshme të trashëgimisë botërore natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit dhe
- përfshirja e Republikës së Maqedonisë dhe komunave të Ohrit, Strugës dhe Debërcës në sistemin ndërkombëtar të bashkëpunimit dhe ndihmës, me qëllim të mbrojtjes ndërkombëtare të trashëgimisë botërore natyrore dhe kulturore.

Neni 4

Zbatimi i rregullave tjera

(1) Krahas dispozitave të këtij ligji, gjatë menaxhimit me trashëgiminë botërore natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit, zbatohen edhe dispozitat e Konventës së UNESCO-s dhe dokumentet e miratuara nga organet e kësaj Konvente.

(2) Për çështjet që nuk janë të rregulluara me këtë ligj, ndërsa kanë të bëjnë me mbrojtjen e trashëgimisë natyrore zbatohen edhe dispozitat e Ligjit për mbrojtje të natyrës dhe rregullat e miratuara në bazë të atij ligji.

(3) Për çështjet që nuk janë të rregulluara me këtë ligj, ndërsa kanë të bëjnë me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, zbatohen edhe dispozitat nga Ligji për mbrojtje të trashëgimisë kulturore dhe rregullat e miratuara në bazë të atij ligji.

(4) Për çështjet që nuk janë të rregulluara me këtë ligj, ndërsa kanë të bëjnë me planifikimin, menaxhimin dhe ekonomizimin (rritjen, mbrojtjen dhe shfrytëzimin) me pyjet dhe egërsira në vendin e gjahut, zbatohen dispozitat e Ligjit për pyjet dhe Ligjit për gjuetinë.

Neni 5

Definicione

Shprehjet e veçanta sipas këtij ligji, e kanë kuptimin si vijojnë:

1. Trashëgimi botërore natyrore dhe kulturore në rrezik është trashëgimia natyrore dhe kulturore të cilës i kërcënohet rrezik serioz dhe konkret, siç janë: kërcënim i shkatërrimi për shkak të shembjes së përsheptuar të shkaktuar nga zbatimi i projekteve të punëve të mëdha publike dhe private, zhvillimi urban dhe turistik, shkatërrimi për shkak të ndryshimit në shfrytëzimin apo pronësinë e tokës, ndryshime të konsiderueshme të shkaktuara për arsye të panjohura, lënia pas dore për çfarëdo arsyesh, rrezikimi për shkak të kryerjes së veprimtarive me karakter luftarak, ndryshimet klimatike, zjarret, ndryshimi i nivelit të ujërave, vërshimet dhe katastrofat natyrore;

2. Posedues i trashëgimisë botërore natyrore në rajonin e Ohrit është çdo person juridik ose fizik, organi i pushtetit shtetëror apo lokal, institucioni privat apo publik që menaxhon me tokën në të cilën gjendet trashëgimia natyrore, apo menaxhon me gjendjen dhe popullatën e një lloji dhe gjendjen me vendbanimin e tij dhe

3. Posedues i trashëgimisë botërore kulturore në rajonin e Ohrit është çdo person juridik apo fizik që është pronar, bartësi i së drejtës së shfrytëzimit dhe çdo person tjetër juridik dhe fizik i cili në cilëndo bazë juridike e shfrytëzon të mirën e mbrojtur kulturore në rajonin e Ohrit.

Neni 6

Parimi i mbrojtjes së detyruar

Republika e Maqedonisë dhe organet e njësive të vetadministrimit lokal duhet të ndërmarrin masa për zbulim, mbrojtje, popullarizim dhe bartje të gjeneratave të ardhshme të trashëgimisë botërore kulturore dhe natyrore në rajonin e Ohrit me rëndësi të jashtëzakonshme, për ç'arsye duhet të mbrohet si pjesë e trashëgimisë së përgjithshme e tërë njerëzimit.

Neni 7

Parimi i bashkëpunimit ndërkombëtar

Republika e Maqedonisë dhe organet e njësive të vetadministrimit lokal, në mënyrë aktive marrin pjesë në bashkëpunimin bilateral, rajonal dhe më të gjerë ndërkombëtar me qëllim të mbrojtjes së trashëgimisë botërore kulturore dhe natyrore, e organizuar në bazë të përhershme

dhe në pajtim me metodat shkencore moderne, ofrojnë ndihmë në përcaktimin, mbrojtjen dhe popullarizimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore si trashëgimi e përgjithshme e tërë njerëzimit, si dhe në mënyrë aktive marrin pjesë në sistemin ndërkombëtar të bashkëpunimit dhe ndihmës me qëllim të realizimit të mbrojtjes ndërkombëtare të trashëgimisë botërore natyrore dhe kulturore.

II. TRASHËGIMIA BOTËRORE NATYRORE DHE KULTURORE NË RAJONIN E OHRIT

Neni 8

Kufijtë

(1) Kufijtë e rajonit të Ohrit në të cilët gjendet trashëgimia natyrore dhe kulturore si trashëgimi botërore janë: fillon nga vendkalimi kufitar te Shën Naumi prej ku shtrihet në lindje dhe verilindje nëpër vijën kufitare ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë deri në shtyllën kufitare F 11/I. Prej këtu kufiri kthehet në drejtim të veriut, del në lartësinë mbidetare prej 1102m në Galiçicën e Vjetër, prej ku ngrihet mbi lartësinë më të madhe mbidetare, e pastaj lëshohet nëpër luginën që përfundon te vendi i quajtur Lipova Livada në lartësi mbidetare prej 1568 m. Prej këtu kufiri kthen në drejtim të lindjes dhe nëpër rrugën e asfaltuar shpie në vendin Plosi i Poshtëm, prej ku e ndërron drejtimin kah veriu duke u ngjitur në majën Tomoros - p.t. me kuotë 1673 m. Prej këtu kufiri e mban drejtimin e njëjtë dhe shkon nëpër lartësinë Presekë - p.t. me kuotë 1633 m, Tumba - p.t. me kuotë 1605 m, Shagon - p.t. me kuotë 1622 m, Samar - p.t. me kuotë 1657 m, Cërven Kamen - p.t. me kuotë 1660 m, Garvanov Kamen, Samernica - p.t. me kuotë 1346 m, Bajçinov Rid - p.t. me kuotë 1380 m, e pret rrugën Ohër – Resnjë dhe del në lartësinë Përçishtë – p.t. me kuotë 1184 m, e pastaj në Stagovë – p.t. me kuotë 1327 m dhe në Kalipadinjë – me kuotë 1372 m. Prej këtu kufiri vazhdon të shtrihet në drejtim të veriut dhe lëshohet në pikën e lartësisë me kuotë 1 268 m, kalon nëpër kodrën Nikotinec – me kuotë 1131 m, prej ku lëshohet në vendin Privja Voda – me kuotë 899 m. Prej këtu kufiri e ndërron drejtimin dhe shtrihet në veriperëndim duke u ngjitur në kodrën e Gradishtes – p.t. me kuotë 1086 m. Prej këtu kufiri lëshohet dhe kalon nëpër pjesët jugore të Debërcës, pastaj nëpër kodrën e Goricës – p.t. me kuotë 877 m, e pret Sateska Rekën, kalon nëpër vendin e quajtur Tumba e Sipërme dhe kuotën 1270 m, pastaj nëpër lartësinë Kodra Mare – p.t. me kuotë 1436 m dhe pikën e lartësisë me kuotë 1522 m, lëshohet kah vendi i quajtur Grikovec, kalon nëpër fshatin Toska dhe del në pikën e lartësisë 971 m. Prej këtu kufiri e ndërron drejtimin kah jugu, e pret lumin Drini i Zi, kalon nëpër Suvo Pole, pastaj nëpër p.t. 754 m dhe 714 m, e pret bregun Krasta e Poshtme, e pret rrugën f. Vranishtë – f. Oktisi, kalon nëpër pikën e lartësisë 752 m dhe nëpër pjesët lindore të Sinje Bërdos, kalon nëpër pikën e lartësisë 864 m, e pret rrugën Strugë – f. Vishni, kalon nëpër kuotën 1026 m, pastaj nëpër vendin Bango dhe Conga, pikën e lartësisë 1165, pikat trigonometrike 1144 (Karalishte), 1103 (Krasje) dhe 1179 dhe del në vendkalimin kufitar Qafa e Thanës në kufirin maqedonas-shqiptar. Prej këtu kufiri e ndërron drejtimin kah lindja dhe në gjatësi prej 2,2 km shpie në bregun e Liqenit të Ohrit përgjatë kufirit me Shqipërinë, e pastaj shtrihet nëpër Liqenin e Ohrit që të përfundojë në vendkalimin kufitar në Shën Naum. Sipërfaqja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore e rajonit të Ohrit është 833,5 km².

(2) Kufijtë e trashëgimisë botërore natyrore dhe kulturore të rajonit të Ohrit nga paragrafi (1) i këtij neni, Agjencia për Kadastër të Patundshmërive i paraqet në bazën gjeodezike në përpjestim 1:1000.

Neni 9

Mënyra e menaxhimit

Menaxhimi me trashëgiminë botërore natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit, realizohet në mënyrë me të cilën sigurohet:

- zbulimi, mbrojtja, popullarizimi dhe përparimi i gjendjes me trashëgiminë natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit,
- bartja te gjeneratat e ardhshme e vlerave të jashtëzakonshme të trashëgimisë botërore natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit, si pjesë e trashëgimisë së përgjithshme e tërë njerëzimit,
- realizimi i hulumtimeve shkencore dhe aktiviteteve edukative arsimore, - parandalimi i aktiviteteve të cilat negativisht ndikojnë mbi vlerat e jashtëzakonshme të trashëgimisë natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit dhe
- përfshirja në sistemin ndërkombëtar të bashkëpunimit dhe ndihmës, me qëllim të mbrojtjes ndërkombëtare të trashëgimisë botërore natyrore dhe kulturore.

Neni 10

Komisioni për Menaxhim me Trashëgiminë Botërore Natyrore dhe Kulturore në Rajonin e Ohrit

(1) Me qëllim të koordinimit të punëve nga neni 9 i këtij ligji, formohet Komisioni për Menaxhim me Trashëgiminë Botërore Natyrore dhe Kulturore në Rajonin e Ohrit si trup koordinues dhe këshillëdhënës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni).

(2) Komisioni është i përbërë nga kryetari, zëvendëskryetari dhe 21 anëtarë, të cilët i emëron Qeveria e Republikës së Maqedonisë, në bazë të propozimit të përbashkët të dorëzuar nga ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mbrojtjes së natyrës dhe ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e kulturës, i formuar në pajtim me principet e përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të qytetaraëve të bashkësive tjera etnike në Republikën e Maqedonisë.

(3) Anëtarët e Komisionit zgjidhen në mënyrën si vijon:

- 1) një anëtar me propozim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë;
- 2) një anëtar me propozim të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, nga radhët e të punësuarve në organ apo nga radhët e punëtorëve të shquar shkencorë nga sfera e mbrojtjes së trashëgimisë natyrore;
- 3) një anëtar me propozim të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e kulturës nga radhët e të punësuarve në organ apo nga radhët e punëtorëve të shquar shkencorë nga sfera e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore;
- 4) një anëtar me propozim të Këshillit Nacional për Zhvillim të Qëndrueshëm të Republikës së Maqedonisë;
- 5) një anëtar nga Instituti i Biologjisë i Fakultetit Matematikor Natyror të Universitetit "Shën. Cirili dhe Metodi" - Shkup, nga radhët e punëtorëve të shquar shkencorë nga sfera e mbrojtjes së trashëgimisë natyrore;
- 6) një anëtar nga Instituti i Historisë dhe Artit dhe Arkeologjisë të Fakultetit Filozofik në Shkup, nga radhët e punëtorëve të shquar shkencorë nga sfera e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore;
- 7) një anëtar me propozim të Drejtorisë për Mjedisin Jetësor nga radhët e të punësuarve në Drejtori, që punojnë në çështje të mbrojtjes së trashëgimisë natyrore në rajonin e Ohrit, ose nga radhët e punëtorëve të shquar shkencorë nga sfera e mbrojtjes së trashëgimisë natyrore;
- 8) një anëtar me propozim të Drejtorisë për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore nga radhët e të punësuarve në Drejtori, që punojnë në çështje të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore në rajonin e Ohrit, ose nga radhët e punëtorëve të shquar shkencorë nga sfera e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore;
- 9) një anëtar me propozim të kryetarit të komunës së Ohrit;
- 10) një anëtar me propozim të kryetarit të komunës së Strugës;

- 11) një anëtar me propozim të kryetarit të komunës së Debërcës;
 - 12) një anëtar me propozim të Institucionit Publik Shkencor Enti Hidrobiologjik, Ohër;
 - 13) një anëtar me propozim të Institucionit Publik Parku Nacional Galiçica;
 - 14) një anëtar përfaqësues i Institucionit Publik Instituti i Ekologjisë dhe Teknologjisë në Strugë;
 - 15) një anëtar me propozim të Kishës Ortodokse Maqedonase;
 - 16) një anëtar me propozim të Bashkësisë Fetare Islame;
 - 17) një anëtar përfaqësues nga asociacioni turistik në rajonin e Ohrit;
 - 18) një anëtar përfaqësues nga organizata joqeveritare nga sfera e mbrojtjes së trashëgimisë natyrore nga rajoni i Ohrit;
 - 19) një anëtar përfaqësues nga organizata joqeveritare nga sfera e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore nga rajoni i Ohrit;
 - 20) një anëtar përfaqësues nga Institucioni Nacional Enti për Mbrojtje të Monumenteve Kulturore dhe Muzeu-Ohër;
 - 21) një anëtar përfaqësues nga Institucioni Nacional Muzeu "Dr. Nikolla Nežllobinski"-Strugë;
 - 22) një anëtar përfaqësues nga Institucioni Nacional-Qendra Nationale Konzervuese-Shkup dhe
 - 23) një anëtar përfaqësues nga Komisioni Nacional për UNESCO-n.
- (4) Me propozim të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mbrojtjes së natyrës, të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e kulturës, të kryetarit të komunës së Ohrit, të kryetarit të komunës së Strugës dhe të kryetarit të komunës së Debërcës munden që si persona profesionalë që do të marrin pjesë në punën e Komisionit pa të drejtë vote, të propozohen edhe përfaqësues nga institucione tjera shkencore, arsimore dhe profesionale të cilët veprojnë në sferën e mbrojtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit.
- (5) Kryetari, zëvendëskryetari dhe anëtarët e Komisionit zgjidhen në kohë prej tri vitesh me të drejtë të rizgjidhjes, mirëpo jo më tepër se dy herë njëra pas tjetrës.
- (6) Për kryetar të Komisionit mund të zgjidhet personi nga radhët e anëtarëve të propozuar nga paragrafi (3) i këtij neni, i cili ka së paku pesë vjet përvojë pune në menaxhimin me trashëgiminë natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit.
- (7) Puna e Komisionit është publike dhe në të pa të drejtë vote, mund të marrin pjesë përfaqësues të institucioneve shkencore, arsimore dhe profesionale dhe palë tjera të interesuara, përfaqësues të medimeve, publiku dhe përfaqësues të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

Neni 11

Fushëveprimi i Komisionit

- (1) Komisioni i kryen punët si në vijim:
 - 1) e shqyrton dhe jep mendim për projekt-raportin nga neni 30 i këtij ligji;
 - 2) i shqyrton dhe jep mendim për zbatimin e ligjeve dhe rregullave të tjera me të cilat rregullohen çështjet nga sfera e mbrojtjes së trashëgimisë botërore natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit;
 - 3) e shqyrton dhe jep mendim për Planin për menaxhim me trashëgiminë botërore natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit;
 - 4) i shqyrton dhe jep mendim për planet e tjera me të cilat ballafaqohet në menaxhimin me trashëgiminë natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit;
 - 5) i shqyrton dhe jep mendim për planet hapësinore dhe urbanistike në rajonin e Ohrit;
 - 6) e ndjek dhe jep mendim për gjendjen me trashëgiminë botërore natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit;

7) e shqyrton gjendjen dhe propozon masa për përmirësimin e gjendjes me trashëgiminë botërore natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit, në iniciativë të vet dhe/ose me kërkesë të personit tjetër juridik apo fizik apo organit të pushtetit shtetëror apo lokal dhe

8) shqyrton dhe jep mendim për çështje tjera në lidhje me menaxhimin me trashëgiminë botërore natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit.

(2) Për ndjekjen e realizimit të Planit për menaxhim me trashëgiminë botërore natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit nga neni 13 i këtij ligji, Komisioni mund të formojë trup të veçantë të përbërë nga institucione shkencore dhe arsimore dhe organizata tjera profesionale, të propozuara në pajtim me nenin 10 paragrafi (4) të këtij ligji.

(3) Për realizimin e punëve nga paragrafi (1) i këtij neni, Komisioni jep mendime, përcakton qëndrime dhe propozime dhe propozon miratim të rregullave dhe marrjen e masave për menaxhim me trashëgiminë botërore natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit.

(4) Komisioni vendos me shumicë votash, nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.

Neni 12

Rregullorja, kompensimi dhe kryerja e punëve administrative-teknike

(1) Komisioni miraton Rregullore për punën e vet.

(2) Anëtarëve të Komisionit u takon kompensim për punën e tyre në Komision.

(3) Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozim të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mbrojtjes së natyrës dhe ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e kulturës, e përcakton lartësinë e kompensimit nga paragrafi (2) të këtij neni, varësisht nga vëllimi dhe ndërlikueshmëria e punëve që kryejnë anëtarët e Komisionit.

(4) Mjetet për kompensim dhe shpenzimet për punë të Komisionit, sigurohen nga buxheti i organit të administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mbrojtjes së natyrës dhe organit të administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e kulturës, dhe atë çdo organ e bart gjysmën nga kompensimi dhe shpenzimet për punën e Komisionit.

(5) Punët profesionale dhe administrative-teknike të nevojshme për punën e Komisionit, i kryejnë organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mbrojtjes së natyrës dhe organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e kulturës.

III. PLANIFIKIMI I MENAXHIMIT ME TRASHËGIMINË BOTËRORE NATYRORE DHE KULTURORE NË RAJONIN E OHRIT

Neni 13

Plani për menaxhim me trashëgiminë botërore natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit

(1) Për menaxhim me trashëgiminë botërore natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit, Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mbrojtjes së natyrës dhe ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e kulturës, e pas mendimit paraprak të Komisionit Nacional të UNESCO-s, miraton Plan për menaxhim me trashëgiminë botërore natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit me plan aksional (në tekstin e mëtejshëm: Plani).

(2) Plani miratohet për periudhën prej nëntë vitesh.

(3) Plani veçanërisht i përmban: hyrjen në të cilën përmbahen të dhënat për vlerat, rëndësinë, karakteristikat, kufijtë e shprehur tekstualisht dhe nëpërmjet hartës, metodologjia e përgatitjes, gjendjen dhe kriteret e vlerësimit të trashëgimisë natyrore dhe kulturore; menaxhimin në të cilin

përmbahen qëllimet, nevojat, statusi, baza ligjore dhe përgatitja e planit; zhvillimi historik i rajonit të Ohrit dhe mënyra e menaxhimit të tij dhe shfrytëzimi; vlerat në të cilat janë të përfshira vlerat e jashtëzakonshme universale, kulturat, vlerat natyrore dhe socio-ekonomike dhe zonat në të cilat gjendeshin ato vlera; faktorët dhe rreziqet që i rrezikojnë vlerat e trashëgimisë botërore natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit; potencialet; vizionin; qëllimet kryesore të planit; çështjet kryesore për menaxhim në të cilat përfshihen çështjet politike dhe juridike, bashkëpunimi ndërmjet organeve të pushtetit shtetëror dhe lokal dhe organet tjera dhe institucionet, pronësia, menaxhimi, financimi, zhvillimi urbanistik, gjendja me mjedisin jetësor, infrastrukturë, turizmi, arsimi, ngritja e vetëdijës publike, resurset njerëzore, shërbimet publike dhe mirëmbajtja; plani aksional për zbatim të planit në të cilin janë të përmbajtura masat dhe aksionet me kornizë kohore për zbatimin e tyre; mënyra e zbatimit të planit dhe organet e pushtetit shtetëror dhe lokal, personat juridikë dhe fizikë, personat publikë dhe privatë dhe zotëruesit e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të cilët janë të detyruar që ta zbatojnë planin, si dhe punë të tjera të cilat janë të domosdoshme për hartimin dhe zbatimin e planit.

(4) Planin i përmban Planin aksional, rezime dhe literaturën e shfrytëzuar dhe shtojca tjera.

Neni 14

Bashkëpunimi në përpilimin e planit

(1) Planin e përpilojnë Drejtoria e Mjedisit Jetësor dhe Drejtoria për Mbrojtje të Trashëgimisë Kulturore.

(2) Drejtoria e Mjedisit Jetësor dhe Drejtoria për Mbrojtje të Trashëgimisë Kulturore, janë të detyruara që gjatë përpilimit të planit t'i marrin parasysh mendimet dhe propozimet e komisionit nga neni 10 i këtij ligji, të përfshijnë institucione shkencore dhe arsimore dhe organizata tjera profesionale, si dhe institucione tjera publike apo persona juridikë, të cilët drejtpërdrejtë apo tërthorazi me kryerjen e veprimtarisë së vet ndikojnë mbi trashëgiminë natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit.

Neni 15

Debati publik

(1) Para dorëzimit të Planit në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, Drejtoria e Mjedisit Jetësor dhe Drejtoria për Mbrojtje të Trashëgimisë Kulturore janë të detyruara që të organizojnë një apo më tepër debate publike për projekt-planin.

(2) Për planin realizohet vlerësimi strategjik i ndikimit mbi mjedisin jetësor në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor.

Neni 16

Realizimi i planit

Planin e realizojnë Drejtoria e Mjedisit Jetësor dhe Drejtoria për Mbrojtje të Trashëgimisë Kulturore, kryetari i komunës së Ohrit, kryetari i komunës së Strugës dhe kryetari i komunës së Debërcës, poseduesit e trashëgimisë natyrore dhe kulturore dhe subjektet tjera, secili në kuadër të autorizimeve dhe kompetencave të veta dhe në pajtim me aktivitetet e përcaktuara në plan.

Neni 17

Planifikimi i zhvillimit urban

(1) Kryetari i komunës së Ohrit, kryetari i komunës së Strugës dhe kryetari i komunës së Debërcës, janë të detyruar që planet urbanistike apo ndryshimin e planeve ekzistuese urbanistike, t'i dorëzojnë për mendim në organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mbrojtjes së natyrës dhe organit të administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e kulturës, si dhe në Komisionin nga neni 10 i këtij ligji para se të fillojnë me realizimin e debatit publik për të njëjtat.

(2) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mbrojtjes së natyrës, ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e kulturës dhe Komisioni nga neni 10 i këtij ligji, janë të detyruar që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të planeve urbanistike dhe ndryshimin e planeve ekzistuese urbanistike, t'i dorëzojnë mendim kryetarit të komunës së Ohrit, kryetarit të komunës së Strugës apo kryetarit të komunës së Debërcës.

(3) Kryetari i komunës së Ohrit, kryetari i komunës së Strugës dhe kryetari i komunës së Debërcës janë të detyruar që në planet urbanistike apo ndryshimin e planeve ekzistuese t'i inkorporojnë mendimet e marra nga organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mbrojtjes së natyrës dhe organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e kulturës dhe mendimet e marra nga Komisioni nga neni 10 i këtij ligji.

(4) Nëse në afatin e përcaktuar në paragrafin (2) të këtij neni, organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mbrojtjes së natyrës dhe organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e kulturës dhe Komisioni nga neni 10 i këtij ligji, nuk dorëzojnë mendim, do të konsiderohet se nuk kanë vërejtje për planet e dorëzuara urbanistike apo ndryshimet e tyre.

Neni 18

Hulumtimet shkencore

Organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mbrojtjes së natyrës, organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e kulturës, kryetari i komunës së Ohrit, kryetari i komunës së Strugës dhe kryetari i komunës së Debërcës, secili në kuadër të kompetencave të tyre, janë të detyruar që të ndërmarrin masa për nxitje të zbatimit të aktiviteteve hulumtuese shkencore, për mbrojtjen e trashëgimisë botërore natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit.

Neni 19

Programet arsimore

(1) Organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mbrojtjes së natyrës, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e kulturës, kryetari i komunës së Ohrit, kryetari i komunës së Strugës dhe kryetari i komunës së Debërcës, secili në kuadër të kompetencave të veta, janë të detyruar që të ndërmarrin masa për nxitje të realizimit të aktiviteteve hulumtuese shkencore për mbrojtjen e trashëgimisë botërore natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit.

(2) Subjektet nga paragrafi (1) të këtij neni, janë të obliguar që ta informojnë publikun për vlerat e trashëgimisë botërore natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit, për rreziqet që i kanosen trashëgimisë natyrore dhe kulturore, si dhe për masat e ndërmarra për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit.

IV. MENAXHIMI ME TRASHËGIMINË BOTËRORE NATYRORE DHE KULTURORE

Neni 20

Lista e trashëgimisë botërore natyrore në rajonin e Ohrit

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mbrojtjes së natyrës është i detyruar që në çdo gjashtë vite të bëjë revizion të Listës së trashëgimisë botërore natyrore dhe karakteristikat e saj në rajonin e Ohrit, që është i regjistruar në listën e Konventës së UNESCO-s.

(2) Poseduesit e trashëgimisë botërore natyrore në rajonin e Ohrit që është në Listën nga paragrafi (1) i këtij neni, janë të detyruar që në vend të dukshëm të trashëgimisë natyrore ta vendosin shenjë për trashëgiminë botërore, të miratuar nga ana e organeve të Konventës së UNESCO-s.

(3) Listën nga paragrafi (1) i këtij neni, e mban Drejtoria e Mjedisit Jetësor.

(4) Nominimin e së mirës së re të veçantë në Konventën e UNESCO-s, si trashëgimi natyrore me rëndësi të veçantë që duhet të hyjë në Listën e trashëgimisë botërore natyrore në rajonin e Ohrit, e kryen Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozim të ministrit i cili udhëheq me organin kompetent për kryerjen e punëve për mbrojtjen e natyrës, kryetari i komunës së Ohrit, kryetari i komunës së Strugës dhe kryetari i komunës së Debërcës.

Neni 21

Pronësia e trashëgimisë botërore natyrore

(1) Toka me trashëgimi botërore natyrore në rajonin e Ohrit mund të jetë në pronësi të Republikës së Maqedonisë, të njësive të vetadministrimit lokal në zonat e të cilave gjendet trashëgimia botërore natyrore dhe të personave të tjerë juridikë dhe fizikë.

(2) Lloji dhe vendbanimi i tij është në pronësi të Republikës së Maqedonisë, pa marrë parasysh pronësinë e tokës në të cilën gjendet trashëgimia botërore natyrore.

(3) Pronari i tokës në të cilën gjendet trashëgimia botërore natyrore është i detyruar që të kujdeset për llojet dhe vendbanimet e tyre në mënyrën e përcaktuar me këtë ligj dhe dispozitat nga Ligji për mbrojtje të natyrës dhe rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji.

(4) Poseduesi i trashëgimisë botërore natyrore në rajonin e Ohrit mund ta shfrytëzojë trashëgiminë natyrore në mënyrë edhe me kushte të përcaktuara me këtë ose me ligj tjetër.

(5) Pronari privat ka të drejtë për kompensim, në pajtim me Ligjin për mbrojtje të natyrës, nëse për shkak të nevojës që të kujdeset për llojet dhe vendbanimet e tyre e shfrytëzon tokën ndryshe nga mënyra e zakonshme e shfrytëzimit, edhe nëse për shkak të saj pëson humbje apo shpenzime plotësuese.

Neni 22

Qasja e publikut

(1) Trashëgimia botërore natyrore në rajonin e Ohrit, si dhe dokumentacioni shkencor dhe profesional i janë të kapshme publikut, në pajtim me dispozitat e këtij ligji ose ligjit tjetër.

(2) Në rast të organizimit të manifestimeve arsimore, shkencore dhe kulturore, poseduesi i trashëgimisë botërore natyrore në rajonin e Ohrit është i detyruar që të mundësojë e njëjta të shfrytëzohet për këtë qëllim.

Neni 23

Shfrytëzimi i trashëgimisë botërore natyrore

(1) Trashëgimia botërore natyrore në rajonin e Ohrit, shfrytëzohet në mënyrën dhe në vëllimin e përcaktuar në Planin për menaxhim me trashëgiminë botërore natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit, nga neni 13 të këtij ligji.

(2) Trashëgimia botërore natyrore në rajonin e Ohrit shfrytëzohet në mënyrën e cila mundëson ruajtjen e saj në gjendje burimore, ruajtjen dhe përtrirjen e llojllojshmërisë biologjike dhe rajonale ekzistuese në gjendje të baraspeshës natyrore dhe sigurimin e shfrytëzimit të qëndrueshëm të trashëgimisë natyrore në interes të zhvillimit të tanishëm dhe të ardhshëm.

Neni 24

Mbrojtja e përkohshme apo e përhershme

Në rast kur është e rrezikuar popullata apo vendbanimi i llojit të veçantë që hyn në listën nga neni 20 i këtij ligji, me çfarë trashëgimia natyrore vihet në gjendje të rrezikshmërisë, ministri kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mbrojtjes së natyrës, është i detyruar që të ndërmarë masa dhe regjim të veçanta të menaxhimit, me qëllim që të sigurojë mbrojtje të përkohshme apo të përhershme të atij lloji, në bashkëpunim me organet tjera të pushtetit shtetëror apo lokal, në pajtim me Ligjin për mbrojtje të natyrës dhe rregullat e miratuara në bazë të atij ligji.

Neni 25

**Lista e trashëgimisë botërore kulturore
në rajonin e Ohrit**

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e kulturës, është e detyruar që në çdo gjashtë vjet të bëjë revizion të Listës së trashëgimisë kulturore botërore natyrore dhe karakteristikat e saj në rajonin e Ohrit, që është regjistruar në Listën e Konventës së UNESCO-s.

(2) Listën nga paragrafi (1) i këtij neni, e mban Drejtoria për Trashëgimi Kulturore.

(3) Për çdo të mirë të veçantë kulturore që është e përmbajtur në listën e trashëgimisë botërore kulturore në rajonin e Ohrit të Konventës së UNESCO-s, miratohet akt i veçantë për mbrojtje në procedurën e përcaktuar në pajtim me Ligjin për mbrojtje të trashëgimisë kulturore.

(4) Nominimin e së mirës së re të veçantë në Konventën e UNESCO-s, si trashëgimi kulturore me rëndësi të veçantë që duhet të hyjë në Listën e trashëgimisë botërore kulturore në rajonin e Ohrit, e kryen Qeveria e Republikës së Maqedonisë, në procedurën e përcaktuar me Ligjin për mbrojtje të trashëgimisë kulturore.

(5) Shenja për trashëgiminë botërore kulturore përdoret në mënyrën e përcaktuar me Rregulloren për përdorimin e shenjave të trashëgimisë kulturore të përcaktuara me marrëveshje ndërkombëtare.

Neni 26

Pronësia e trashëgimisë botërore kulturore

(1) Trashëgimia e patundshme dhe e tundshme botërore kulturore në rajonin e Ohrit, mund të jetë në pronësi të Republikës së Maqedonisë, të njësive të vetadministrimit lokal dhe të personave tjerë juridikë dhe fizikë.

(2) Trashëgimia kulturore dhe e mira për të cilën me bazë supozohet se është trashëgimi kulturore që do të gjendet në tokë apo në ujë, pa marrë parasysh nëse është nxjerrë, konsiderohet se është në pronësi të Republikës së Maqedonisë.

Neni 27

Qasja e publikut

(1) Trashëgimia botërore kulturore në rajonin e Ohrit, si dhe dokumentacioni shkencor dhe profesional, i janë të kapshme publikut në pajtim me dispozitat e këtij ligji ose ligjit tjetër.

(2) Në rast të organizimit të manifestimeve arsimore, shkencore dhe kulturore poseduesi i trashëgimisë kulturore në rajonin e Ohrit, është i detyruar të mundësojë që e njëjta të shfrytëzohet për atë qëllim.

Neni 28

Shfrytëzimi i trashëgimisë botërore kulturore

(1) Trashëgimia botërore kulturore në rajonin e Ohrit, shfrytëzohet në mënyrë dhe në vëllimin e përcaktuar në Planin nga neni 13 i këtij ligji.

(2) Trashëgimia botërore kulturore në rajonin e Ohrit, shfrytëzohet në mënyrën e cila mundëson ruajtjen e saj në gjendje burimore, ruajtjen e integritetit dhe aftësohet të shërbejë për plotësimin e nevojave kulturore, shkencore, arsimore, estetike, fetare, ekonomike, turistike dhe të nevojave tjera të qytetarëve dhe shoqërisë.

(3) Për të mirat e veçanta kulturore të cilat gjenden në përbërje të kufijve të trashëgimisë botërore natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit nga neni 8 i këtij ligji, miratohen akte të posaçme për mbrojtje të trashëgimisë kulturore.

(4) Regjimi përkatës i mbrojtjes së trashëgimisë botërore kulturore në rajonin e Ohrit, përcaktohet me aktet për mbrojtje nga paragrafi (3) i këtij neni.

Neni 29

Zbatimi i masave dhe aktiviteteve për mbrojtje

(1) Komuna e Ohrit, e Strugës dhe e Debërcës dhe shërbimet publike bashkë me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mbrojtjes së natyrës dhe organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e kulturës, janë përgjegjëse për menaxhimin dhe për zbatimin e masave dhe aktiviteteve për mbrojtje dhe promovim të trashëgimisë botërore natyrore dhe kulturore të rajonit të Ohrit, në kuadër të kompetencave të tyre të përcaktuara me këtë ligj ose me ligj tjetër .

(2) Poseduesit e trashëgimisë botërore natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit, janë përgjegjës për mirëmbajtjen, ruajtjen, respektimin dhe shfrytëzimin e drejtë të trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

(3) Institucionet Nacionale – Qendra Nacionale Konzervuese – Shkup dhe Enti për Mbrojtje të Përmendoreve të Kulturës dhe Muzeu – Ohër, janë kompetentë për marrjen e masave mbrojtëse-konzervuese të trashëgimisë botërore kulturore në rajonin e Ohrit, secili sipas kompetencave të veta.

(4) Muzeu “Nikolla Nezlobinski” - Strugë, është kompetent për marrjen e masave për mbrojtjen e trashëgiminë së tundshme kulturore dhe natyrore, e cila është pjesë përbërëse e koleksionit të këtij muzeu.

(5) Institucioni Shkencor Publik – Enti Hidrobiologjik – Ohër, është kompetent për propozimin dhe marrjen e masave për mbrojtje të trashëgimisë botërore natyrore në rajonin e Ohrit, hulumtimin e tij shkencor dhe promovimi, si dhe sigurimin e materialit gjenetik të llojeve.

(6) Institucioni Publik - Parku Nacional i Galiçicës, është kompetent për marrjen e masave për mbrojtje të trashëgimisë botërore natyrore në kuadër të zonës së Parkut Nacional të Galiçicës dhe për parandalim të degradimit të trashëgimisë natyrore dhe zonës së parkut nacional, të shkaktuar nga kryerja e veprimtarive dhe aktiviteteve të personave tjerë juridikë dhe fizikë, që zbatohen në kuadër të zonës së parkut nacional.

V. RAPORT PËR GJENDJEN E TRASHËGIMISË BOTËRORE NATYRORE DHE KULTURORE NË RAJONIN E OHRIT

Neni 30

Përgatitja e raportit

(1) Drejtoria e Mjedisit Jetësor dhe Drejtoria për Mbrojtje të Trashëgimisë Kulturore, janë të detyruara që një herë në çdo gjashtë vjet të përgatisin raport për gjendjen e trashëgimisë botërore natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit (në tekstin e mëtejshëm: raporti), në të cilin prezantohet shkalla e rrezikshmërisë së trashëgimisë botërore natyrore dhe kulturore, shkalla e preksshmërisë, përkatësisht rrezikshmërisë së trashëgimisë botërore natyrore, shkalla e ruajtjes së trashëgimisë botërore kulturore në gjendje burimore, masat që janë marrë, si dhe ndryshimet që kanë ndodhur në gjendjen e trashëgimisë botërore natyrore dhe kulturore nga përgatitja e raportit të fundit. Raporti përmban edhe vlerësim për aktivitetet e ndërmarra, të përcaktuara në planin aksional, i cili është pjesë përbërëse e planit nga neni 13 i këtij ligji.

(2) Në raport jepen edhe rekomandime për masat të cilat duhet të ndërmerren për tejkalimin e gjendjeve.

(3) Drejtoria e Mjedisit Jetësor dhe Drejtoria për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore gjatë përgatitjes së raportit, janë të detyruara që të përfshijnë institucione shkencore dhe arsimore dhe organizata profesionale, përfaqësues të komunave të Ohrit, Strugës dhe Debërcës, si dhe institucione tjera publike ose persona juridikë të cilët drejtpërdrejtë apo tërthorazi, me kryerjen e veprimtarisë së tyre, ndikojnë mbi trashëgiminë natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit.

Neni 31

Vlerësimi i rrezikut

(1) Në Raportin nga neni 30 i këtij ligji, Drejtoria e Mjedisit Jetësor dhe Drejtoria për Mbrojtje të Trashëgimisë Kulturore, janë të detyruara të vlerësojnë nëse një pjesë apo e gjithë trashëgimia botërore natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit, është në rrezik.

(2) Vlerësimin nga paragrafi (1) i këtij neni për trashëgiminë botërore natyrore, Drejtoria e Mjedisit Jetësor e kryen në bazë të kriterëve, si vijojnë:

1) rrezik i konstatuar, është kur trashëgimia natyrore ballafaqohet me rrezik specifik dhe rrezik të ardhshëm të dëshmuar, siç janë:

- rënia serioze e popullatës së llojeve të rrezikuara apo llojeve tjera me vlerë të jashtëzakonshme universale për ç'arsye është futur në Listën nga neni 20 i këtij ligji, qoftë për shkak të faktorëve natyrorë siç janë sëmundjet, ose nga faktorët njerëzorë siç janë helmimet,

- përkeqësimi i konsiderueshëm i bukurive natyrore apo vlerave shkencore të trashëgimisë natyrore, i shkaktuar nga vendbanimet e njerëzve, ndërtimi i rezervuareve të cilat vërshojnë pjesë të konsiderueshme të trashëgimisë natyrore, zhvillimi industrial dhe bujqësor, duke përfshirë përdorimin e pesticideve dhe plehrave, punë të mëdha publike dhe infrastrukturore, miniera, ndotje, prerje të pakontrolluar të drurëve dhe ngjashëm dhe

- rrezikimi/cenimi i kufijve apo i zonave përreth, të cilat e rrezikojnë integritetin e trashëgimisë natyrore nga ana e njeriut dhe

2) rrezik potencial, është kur trashëgimia natyrore ballafaqohet me kërcënime të cilat do të mund të ndikojnë në përkeqësimin e vlerave të saj të jashtëzakonshme, me:

- ndryshim të statusit juridik të mbrojtjes së zonës,

- popullim të planifikuar apo kryerje të projekteve zhvillimore brenda në zonën e trashëgimisë natyrore apo jashtë zonës së trashëgimisë natyrore, nëse janë të vendosura në mënyrë që mund të ndikojë në rrezikimin e trashëgimisë natyrore,

- rrezikim nga veprimtaritë ose konfliktet luftarake dhe

- mungesë apo mospërputhje të planit për menaxhim, apo realizim të plotë të planit për menaxhim.

(3) Vlerësimin nga paragrafi (1) i këtij neni, për trashëgiminë botërore kulturore Drejtoria për Mbrojtje të Kulturës e kryen në bazë të kriterëve, si vijojnë:

1) rrezik i konstatuar, është kur trashëgimia kulturore ballafaqohet me rrezik specifik dhe rrezik të ardhshëm të dëshmuar, siç janë:

- shkatërrimi i përsheptuar i materialit nga të cilat janë ndërtuar të mirat kulturore,

- ndryshimet serioze të strukturës apo dekorimit,

- ndryshimet serioze të lidhshmërisë arkitektonike dhe urbanistike të hapësirës urbane dhe rurale apo të mjedisit natyror,

- humbja e dukshme e autenticitetit historik,

- urbanizimi i pakontrolluar i hapësirës,

- shtrembërimi serioz i rëndësisë së tyre kulturore,

- ndryshimet serioze për arsye të panjohura dhe

- riemërtimi i toponimeve dhe

2) rrezik potencial, është kur trashëgimia kulturore ballafaqohet me kërcënime të cilat do të mund të ndikojnë në përkeqësimin e karakteristikave të saj të jashtëzakonshme, siç janë:

- shpërthimi apo kërcënim i shpërthimit i konfliktit të armatosur,

- katastrofat natyrore, veçanërisht tërmetet, vërshimet, rrëshqitja e tokës, zjarret apo ndryshimet progresive nga faktorët gjeologjikë, klimatikë apo nga faktorët tjerë natyrorë,

- lënia pas dore për çfarëdo arsye dhe

- mungesa, mospërputhja apo zbatimi i pamjaftueshëm i planeve dhe programeve për mbrojtje apo regjimit të mbrojtjes që nuk përputhet me statusin mbrojtës-juridik të trashëgimisë kulturore.

Neni 32

Shikimi publik i raportit

(1) Drejtoria e Mjedisit Jetësor dhe Drejtoria për Mbrojtje të Trashëgimisë Kulturore, në afat prej 15 ditësh nga dita e përgatitjes së projekt-raportit nga neni 30 i këtij ligji, janë të detyruara që t'ia dorëzojnë Raportin për mendim kryetarit të komunës së Ohrit, kryetarit të komunës së Strugës dhe kryetarit të komunës së Debërcës dhe institucioneve tjera shkencore dhe arsimore dhe organizatave profesionale, si dhe ta paraqesë në shikim për publikun.

(2) Kryetari i komunës së Ohrit, kryetari i komunës së Strugës dhe kryetari i komunës së Debërcës, institucionet shkencore dhe arsimore dhe organizatat profesionale dhe publiku, kanë të drejtë që të dorëzojnë mendim në Drejtorinë e Mjedisit Jetësor dhe/ose Drejtorinë për Mbrojtje të Trashëgimisë Kulturore, në lidhje me projekt-raportin, në afat jo më të shkurtër se 30 ditë por jo më të gjatë se 60 ditë nga dita e marrjes, përkatësisht shpalljes të raportit.

(3) Drejtoria e Mjedisit Jetësor dhe Drejtoria për Mbrojtje të Trashëgimisë Kulturore, janë të detyruara që në afat prej tetë ditësh nga dita e botimit të projekt-raportit në ueb faqen e tyre, të botojnë njoftim për fillimin e shikimit publik në më së paku dy gazeta ditore të kapshme në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë, në të cilat do të jepet afati dhe vendi ku mund të bëhet shikimi i raportit.

Neni 33

Miratimi i raportit

(1) Drejtoria e Mjedisit Jetësor dhe Drejtoria për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore, janë të detyruara që në tekstin përfundimtar të raportit në mënyrë adekuate t'i përfshijnë mendimet e marra nga shikimi i realizuar publik dhe ta dorëzojnë te ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mbrojtjes së natyrës dhe te ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e kulturës, Komisioni për Menaxhim me Trashëgiminë Natyrore dhe Kulturore në Rajonin e Ohrit dhe në Komisionin Nacional dhe Komitetin Nacional për UNESCO-n të Republikës së Maqedonisë, në afat prej 30 ditësh nga dita e përgatitjes së tekstit përfundimtar të raportit.

(2) Pas miratimit të Raportit nga ana e Komisionit Nacional për UNESCO-n të Republikës së Maqedonisë dhe Komitetit Nacional për UNESCO-n të Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit për Menaxhim me Trashëgiminë Natyrore dhe Kulturore në Rajonin e Ohrit, ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mbrojtjes së natyrës në bashkëpunim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e kulturës, janë të detyruar që raportin ta dorëzojnë për miratim në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë.

Neni 34

Njoftimi

Në rast kur në raportin nga neni 30 i këtij ligji, është përcaktuar se trashëgimia botërore natyrore dhe/ose kulturore në rajonin e Ohrit është në rrezik, ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mbrojtjes së natyrës dhe/ose ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e kulturës janë të detyruar që ta informojnë Komisionin Nacional për UNESCO-n të Republikës së Maqedonisë, në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së raportit.

Neni 35

Dorëzimi i raporteve në UNESCO

Komisioni Nacional për UNESCO-n i Republikës së Maqedonisë, është kompetent për dorëzimin e raporteve në pajtim me dispozitat e Konventës së UNESCO-s, duke e përfshirë edhe raportin nga neni 30 i këtij ligji.

VI. FINANCIMI

Neni 36

Burimet e financimit

(1) Mjetet për zbatimin e këtij ligji, sigurohen nga:

- 1) Buxheti i Republikës së Maqedonisë;
- 2) buxheti i komunës së Ohrit, buxheti i komunës së Strugës dhe buxheti i komunës së Debërcës;
- 3) mjetet e fituara me shfrytëzimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit dhe
- 4) burime tjera (donacione, grante, kredi, dhurata, legate etj.).

(2) Me mjetet nga paragrafi (1) pika 1 të këtij neni, financohet puna e Komisionit për Menaxhim me Trashëgiminë Botërore Natyrore dhe Kulturore në Rajonin e Ohrit dhe përgatitjen e Planit nga neni 13 i këtij ligji dhe raportit për gjendjen me trashëgiminë botërore natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit.

(3) Me mjetet nga paragrafi (1) pika 2 të këtij neni, financohen punët për të cilat në pajtim me këtë ligj janë kompetentë komuna e Ohrit, komuna e Strugës dhe komuna e Debërcës.

(4) Me mjetet nga paragrafi (1) pika 3 të këtij neni, financohen punët për të cilat në pajtim me këtë ligj janë kompetentë poseduesit e trashëgimisë botërore natyrore dhe kulturore, në rajonin e Ohrit.

(5) Me mjetet nga paragrafi (1) pika 4 të këtij neni, financohen punët për të cilat dedikohen të njëjtat.

VII. MBIKËQYRJA

1. Mbikëqyrja mbi zbatimin e ligjit

Neni 37

Kompetenca për kryerjen e mbikëqyrjes mbi zbatimin e Ligjit

(1) Mbikëqyrje mbi zbatimin e këtij ligji dhe rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji në sferën e trashëgimisë natyrore, kryen organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mbrojtjes së natyrës nëpërmjet Drejtorisë së Mjedisit Jetësor.

(2) Mbikëqyrje mbi zbatimin e këtij ligji dhe rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji në sferën e trashëgimisë kulturore, kryen organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e kulturës nëpërmjet Drejtorisë për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore.

Neni 38

Mbikëqyrja mbi punën e organeve të komunës së Ohrit, komunës së Strugës dhe komunës së Debërcës

Në realizimin e mbikëqyrjes mbi zbatimin e këtij ligji, organet kompetente nga neni 37 i këtij ligji, kryejnë mbikëqyrje mbi punën e organeve të komunës së Ohrit, komunës së Strugës dhe komunës së Debërcës, në kryerjen e kompetencave të tyre të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 39

Mbikëqyrja mbi punën e organeve të komunës së Ohrit, komunës së Strugës dhe komunës së Debërcës, bazohet në parimin e ligjshmërisë, përgjegjësisë dhe pavarësisë, në realizimin e kompetencave të tyre.

Neni 40

**Procedura për kryerjen e mbikëqyrjes mbi punën e organeve të komunës së Ohrit,
komunës së Strugës dhe komunës së Debërcës**

Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes mbi punën e organeve të komunës së Ohrit, komunës së Strugës dhe komunës së Debërcës, organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve në sferën e mbrojtjes së natyrës dhe organi i administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve të kulturës, i kryen punët si në vijim:

1) konstaton, nëse komuna e Ohrit, komuna e Strugës dhe komuna e Debërcës menaxhojnë me trashëgiminë botërore natyrore që është në kompetencë të tyre, në mënyrën e përcaktuar në nenin 9 të këtij ligji;

2) vlerëson nëse komuna e Ohrit, komuna e Strugës dhe komuna e Debërcës, planet urbanistike dhe ndryshimet e planeve ekzistuese urbanistike që i miratojnë, i kanë dorëzuar për mendim në Komisionin për Menaxhim me Trashëgiminë Botërore Natyrore dhe Kulturore në Rajonin e Ohrit, në pajtim me nenin 17 të këtij ligji;

3) vlerëson nëse komuna e Ohrit, komuna e Strugës dhe komuna e Debërcës, planet urbanistike dhe ndryshimet e planeve ekzistuese urbanistike që i miratojnë, i kanë dorëzuar në organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mbrojtjes së natyrës, përkatësisht në organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e kulturës, në pajtim me nenin 17 të këtij ligji;

4) vlerëson nëse komuna e Ohrit, komuna e Strugës dhe komuna e Debërcës, si posedues të trashëgimisë botërore natyrore, përkatësisht posedues të trashëgimisë botërore kulturore në rajonin e Ohrit, e kanë vendosur në vend të dukshëm të trashëgimisë natyrore përkatësisht trashëgimisë kulturore, shenjë të trashëgimisë botërore, në pajtim me nenin 20 paragrafi (2) të këtij ligji, përkatësisht në pajtim me nenin 25 paragrafi (5) të këtij ligji;

5) vlerëson nëse komuna e Ohrit, komuna e Strugës dhe komuna e Debërcës, ndërmarrin masa për nxitjen e zbatimit të aktiviteteve hulumtuese shkencore, për mbrojtjen e trashëgimisë botërore natyrore, përkatësisht trashëgimisë botërore kulturore në rajonin e Ohrit;

6) vlerëson nëse komuna e Ohrit, komuna e Strugës dhe komuna e Debërcës, ndërmarrin masa për nxitjen e arsimit dhe zbatimin e programeve informative për njoftimin e popullsisë në drejtim të respektimit dhe pranimit të trashëgimisë botërore natyrore, përkatësisht trashëgimisë botërore kulturore në rajonin e Ohrit;

7) vlerëson nëse komuna e Ohrit, komuna e Strugës dhe komuna e Debërcës, si posedues të trashëgimisë botërore natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit, e shfrytëzojnë në mënyrën dhe me kushtet e përcaktuara me këtë dhe/ose me ligj tjetër (nenet 21 paragrafi (4) dhe 28);

8) vlerëson nëse komuna e Ohrit, komuna e Strugës dhe komuna e Debërcës, si posedues të trashëgimisë botërore natyrore, përkatësisht botërore kulturore në rajonin e Ohrit, ka mundësuar që ajo të shfrytëzohet për organizimin e manifestimeve arsimore, shkencore dhe kulturore (nenet 22 dhe 28);

9) vlerëson nëse komuna e Ohrit dhe komuna e Strugës, kanë për qëllim apo ndërmarrin aktivitete apo veprime mbi trashëgiminë botërore natyrore në rajonin e Ohrit, me të cilat mundet ose mundësohet shfrytëzimi i trashëgimisë natyrore, në kundërshtim me nenin 23 paragrafi (2) të këtij ligji;

10) vlerëson nëse komuna e Ohrit, komuna e Strugës dhe komuna e Debërcës e shfrytëzojnë trashëgiminë botërore natyrore, përkatësisht botërore kulturore, në mënyrën dhe në vëllimin e përcaktuar në planin nga neni 13 i këtij ligji (nenet 23 paragrafi (1) dhe 28 paragrafi (1)) dhe

11) vlerëson nëse komuna e Ohrit, komuna e Strugës dhe komuna e Debërcës, zbatojnë masa dhe aktivitete për mbrojtje dhe promovim të trashëgimisë natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit (neni 29).

Neni 41

Heqja e kryerjes së kompetencave

(1) Nëse edhe përkundër sugjerimeve nga neni 40 të këtij ligji dhe masave dhe aktivitetet e ndërmarra, kryetari dhe/ose këshilli i komunave të Ohrit dhe/ose të Strugës dhe/ose të Debërcës nuk e sigurojnë kryerjen e punëve të cilat me këtë ligj janë të përcaktuara si kompetencë e tyre dhe për kryerjen e së cilës janë përgjegjës, me fuqi të ligjit iu merret kompetenca përkatëse, kurse kryerjen e atyre punëve e ndërmerr organi i administratës shtetërore, kompetent për punët nga sfera e mbrojtjes së natyrës dhe/ose organi i administratës shtetërore, kompetent për punët nga sfera e kulturës, secili në kuadër të kompetencave të tyre, por më së shumti deri në një vit nga dita e marrjes së tyre.

(2) Organi kompetent nga paragrafi (1) i këtij neni, punët në kompetencë të komunave të Ohrit dhe/ose të Strugës, dhe/ose të Debërcës, i kryen në emër dhe në llogari të komunave të Ohrit dhe/ose Strugës dhe/ose Debërcës.

(3) Për marrjen e punëve nga paragrafi (1) i këtij neni, organi kompetent nga paragrafi (2) i këtij neni, e njofton organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e vetadministrimit lokal dhe organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e financave.

2. Mbikëqyrja inspektuese

Neni 42

Kompetenca për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese

(1) Mbikëqyrjen inspektuese mbi zbatimin e këtij ligji dhe të rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji në pjesën e trashëgimisë natyrore, e kryen Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor, nëpërmjet inspektorëve shtetërorë për mbrojtjen e natyrës.

(2) Mbikëqyrjen inspektuese mbi zbatimin e këtij ligji dhe të rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji në pjesën e trashëgimisë kulturore, e kryen Drejtoria për Mbrojtje të Trashëgimisë Kulturore nëpërmjet inspektorëve për trashëgimi kulturore.

Neni 43

Fushëveprimi i inspektorit shtetëror për mbrojtjen e natyrës

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori për mbrojtje të natyrës përveç veprimeve të përcaktuara në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor dhe Ligjin për mbrojtje të natyrës, mund t'i ndërmarrë edhe veprimet si vijojnë:

- të përcaktojë nëse poseduesi i trashëgimisë botërore natyrore, menaxhon me trashëgiminë natyrore, në pajtim me planin nga neni 13 i këtij ligji (neni 16),

- të kryejë kontroll dhe shikim nëse poseduesi i trashëgimisë botërore natyrore, e ka vendosur shenjën për trashëgimi botërore në mënyrën e përcaktuar në nenin 20 paragrafi (3) të këtij ligji dhe

- të kryejë kontroll dhe shikim, nëse trashëgimia botërore natyrore shfrytëzohet në mënyrën dhe në vëllimin e përcaktuar në planin nga neni 13 i këtij ligji (neni 23 paragrafi (1)).

(2) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori shtetëror për mbrojtje të natyrës me aktvendim mund të urdhërojë:

- mënjanimin e të metave që do t'i konstatojë gjatë kryerjes së mbikëqyrjes dhe do të përcaktojë afat për mënjanimin e tyre,

- marrjen e masave me qëllim të sigurimit të menaxhimit të drejtë me trashëgiminë natyrore dhe do të përcaktojë afat për marrjen e tyre,

- vendosjen e shenjës së trashëgimisë botërore dhe do të përcaktojë afat për këtë,

- marrjen e masave me qëllim të sigurimit të shfrytëzimit të drejtë të trashëgimisë botërore natyrore dhe do të përcaktojë afat për marrjen e tyre,

- marrjen e masave që dalin nga plani nga neni 13 i këtij ligji dhe do të përcaktojë afat për marrjen e tyre dhe

- ndalimin për zbatimin e aktiviteteve apo veprimeve të cilat nuk janë në pajtim me planin nga neni 13 i këtij ligji.

(3) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese nga paragrafi (1) i këtij neni, inspektori shtetëror për mbrojtje të natyrës mund të kërkojë prani të personit nga Drejtoria për Mbrojtjen e Natyrës.

Neni 44

Fushëveprimi i inspektorit për trashëgimi kulturore

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori për trashëgimi kulturore, përveç veprimeve të përcaktuara në pajtim me Ligjin për mbrojtje të trashëgimisë kulturore, mund t'i ndërmarrë edhe veprimet si vijojnë:

- të vërtetojë nëse trashëgimia botërore kulturore shfrytëzohet në mënyrën dhe në vëllimin siç është përcaktuar në Planin nga neni 13 i këtij ligji (neni 28) dhe

- të kryejë kontroll dhe shikim nëse poseduesi i trashëgimisë botërore kulturore, menaxhon me trashëgiminë kulturore në pajtim me Planin nga neni 13 i këtij ligji (neni 29).

(2) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori për trashëgimi kulturore me aktvendim mund të urdhërojë:

- marrjen e masave me qëllim të sigurimit të shfrytëzimit të drejtë të trashëgimisë botërore kulturore dhe do të përcaktojë afat për marrjen e tyre,

- marrjen e masave që dalin nga Plani nga neni 13 i këtij ligji dhe do të përcaktojë afat për marrjen e tyre dhe

- ndalimin për zbatimin e aktiviteteve apo veprimeve të cilat nuk janë në pajtim me planin nga neni 13 i këtij ligji.

Neni 45

Obligimet e personave juridikë dhe fizikë gjatë kryerjes së mbikëqyrjes

Me qëllim që të zbatohet mbikëqyrja inspektuese, personat juridikë dhe fizikë janë të detyruar që t'u mundësojnë inspektorëve kompetentë nga nenet 43 dhe 44 të këtij ligji, të drejtë qasjeje dhe shikimi në hapësirat dhe dokumentet e personit juridik dhe fizik, që t'ua dorëzojnë të dhënat, shpjegimet dhe njoftimet e kërkuara, të kryejnë matje dhe të marrin mostra dhe të grumbullojnë argumente, në pajtim me këtë ligj, Ligjin për mbrojtjen e natyrës dhe Ligjin për mbrojtje të trashëgimisë kulturore.

VIII. DISPOZITA PËR KUNDËRVAJTJE

Neni 46

Sanksione për kundërvajtje për personat fizikë

(1) Gjohë në shumë prej 100 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet aty për aty personit fizik për kundërvajtje të kryer, nëse:

- nuk e ka vendosur në vend të dukshëm shenjën për trashëgimi botërore (neni 20 paragrafi (2)).

(2) Inspektori shtetëror për mbrojtje të natyrës, kur do të përcaktojë se është kryer kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni, kryerësit të kundërvajtjes do t'i dorëzojë ftesë për pagesë të gjobës e cila duhet të paguhet në afat prej tetë ditësh nga dita e dorëzimit të ftesës.

(3) Nëse kryerësi i kundërvajtjes në mënyrë vullnetare nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, inspektori shtetëror për mbrojtje të natyrës do të parashtojë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje në Komisionin për Kundërvajtje të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, të formuar në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor.

Neni 47

Gjobë në shumë prej 400 eurosh në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet personit fizik, nëse:

1) menaxhon me trashëgiminë botërore natyrore dhe kulturore, në kundërshtim me mënyrën që është e përcaktuar në nenin 9 të këtij ligji;

2) e shfrytëzon trashëgiminë botërore natyrore në mënyrë dhe në vëllim në kundërshtim me atë që është përcaktuar në planin nga neni 13 i këtij ligji (neni 23 paragrafi (1));

3) e kryen shfrytëzimin e trashëgimisë natyrore në rajonin e Ohrit, në kundërshtim me nenin 23 paragrafi (2) të këtij ligji dhe

4) e shfrytëzon trashëgiminë botërore kulturore në mënyrë dhe në masë, në kundërshtim me atë që është përcaktuar në planin nga neni 13 i këtij ligji, (neni 28 paragrafët (1) dhe (2)).

Neni 48

Sanksione për kundërvajtje për personat juridikë

(1) Gjobë në shumë prej 200 eurosh në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet aty për aty personit fizik për kundërvajtje të kryer, nëse:

- nuk e ka vendosur në vend të dukshëm shenjën për trashëgimi botërore (neni 20 paragrafi (2)).

(2) Gjobë në shumë prej 100 eurosh në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik, për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Inspektori shtetëror për mbrojtje të natyrës, kur do të konstatojë se është kryer kundërvajtje nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, kryerësit të kundërvajtjes do t'i dorëzojë ftesë për pagesë të gjobës, të cilën duhet ta paguajë në afat prej tetë ditësh nga dita e dorëzimit të ftesës.

(4) Nëse kryerësi i kundërvajtjes në mënyrë vullnetare nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, inspektori shtetëror për mbrojtje të natyrës do të parashtrojë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje, në Komisionin për Kundërvajtje të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, të formuar në pajtim me Ligjin për mjedis jetësor.

Neni 49

(1) Gjobë në shumë prej 3 000 eurosh në kundërvlerë me denarë, do të shqiptohet për kundërvajtje të kryer të personit juridik, nëse:

1) menaxhon me trashëgiminë botërore natyrore dhe kulturore, në kundërshtim me mënyrën që është e përcaktuar në nenin 9 të këtij ligji;

2) e shfrytëzon trashëgiminë botërore natyrore në mënyrë dhe në vëllim, në kundërshtim me atë që është përcaktuar në planin nga neni 13 i këtij ligji (neni 23 paragrafi (1));

3) kryen shfrytëzim të trashëgimisë natyrore në rajonin e Ohrit, në kundërshtim me nenin 23 paragrafi (2) të këtij ligji dhe

4) e shfrytëzon trashëgiminë botërore kulturore në mënyrë dhe në masë, në kundërshtim me atë që është përcaktuar në planin nga neni 13 i këtij ligji (neni 28 paragrafët (1) dhe (2)).

(2) Gjobë në shumë prej 800 eurosh në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 50

Procedura për barazim

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 47 dhe 49 të këtij ligji, inspektori shtetëror për mbrojtje të natyrës, përkatësisht inspektori për trashëgiminë kulturore është i detyruar që kryerësit të kundërvajtjes t'i propozojë procedurë për barazim, para se të parashtrojë kërkesë për ngritje të procedurës për kundërvajtje.

(2) Procedurat për barazim të ngritura nga inspektori shtetëror për natyrën, udhëhiqen në pajtim me dispozitat nga Ligji për mjedisin jetësor.

(3) Procedurat për barazim të ngritura nga inspektori për trashëgimi kulturore, udhëhiqen në pajtim me dispozitat nga Ligji për mbrojtje të trashëgimisë kulturore.

Neni 51

Udhëheqja e procedurës për kundërvajtje

Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 47 dhe 49 të këtij ligji, procedurë për kundërvajtje udhëheq dhe sanksion për kundërvajtje shqipton, gjykata kompetente.

IX. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 52

**Komisioni për Menaxhim me Trashëgiminë Botërore Natyrore dhe Kulturore
në Rajonin e Ohrit**

Komisioni për Menaxhim me Trashëgiminë Botërore Natyrore dhe Kulturore në Rajonin e Ohrit, do të themelohet në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 53

**Plani për menaxhim me trashëgiminë botërore natyrore
dhe kulturore në rajonin e Ohrit**

Plani për menaxhim me trashëgiminë botërore natyrore dhe kulturore në rajonin e Ohrit, do të miratohet më së voni në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 54

Dispozita përfundimtare

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.